



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.358/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, paraqitur kundër Subjektit Politik Srpska Lista me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, Anr.358/2025 e datës 04.02.2025.

II. Subjektit Politik Srpska Lista me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i më gjobë në lartësi prej 4.000.00, (katërmijë) Euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Srpska Lista me seli në Mitrovicën e Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, në të cilën pretendohet se më datë 02.02.2025, gjatë vëzhgimit të aktiviteteve të subjekteve tjera politike, kanë vërejtur se Subjekti Politik Srpska Lista në territorin e komunës së Novobërdës, se në disa lokacione, përkatësisht në vendin Prekovcë kanë vendosur postera në vende të paautorizuara siç janë shtyllat elektrike dhe stacionet e autobusëve, gjë që bie ndesh me kodet ligjore të subjekteve politike që shfrytëzojnë objektet për promovim, me çka kanë shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se ata kanë vendosur postera në vende ku nuk janë të destinuara për këtë.

Më tej në ankesë thuhet se bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe që lidhen me ciklin dhe rregullat zgjedhore, duke qenë se shkelja është kryer më 2 shkurt 2025 në orën 11:00, kërkojnë nga PZAP të marrë VENDIMIN si më poshtë:

- Që PZAP ta pranoj ankesën si të bazuar
- Të merr vendim për dënimin e subjektit politik Srpska Lista-Zlatan Elek në pajtim me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Si provë kanë bashkëngjitur fotografi të posterave, të vendosur nga Srpska Lista në komunën e Novobërdës në shtyllat elektrike dhe stacionet e autobusëve në disa lokacione.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik Lista Serbe, theksohet se përmes një hetimi të detajuar kanë konstatuar se aktivistë të rinj dhe pa përvojë të subjektit politik, me dëshirën e tyre për të vendosur sa më shumë materiale zgjedhore, ishin të pakujdeshëm, sepse ky ishte cikli i tyre i parë zgjedhor dhe të rintjtë e subjektit politik Srpska Lista, nuk kishin dijeni se vendosja e posterave në hapësira publike ishte vepër e kundërligjshme. Më tej theksohet se të njëjtit menjëherë i kanë urdhëruar, që të korrigojnë gabimin e tyre dhe të heqin posterat nga hapësirat publike.

Bazuar në të gjitha sa më sipër dhe në përputhje me nenin 118 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, propozojnë si në vijim: Që PZAP-i të pranon argumentet e tyre dhe të njëjtit të ndëshkohen për këtë shkelje, duke marrë parasysh të gjitha rrethana lehtësuese, të miratojë përgjigjen në ankesë si të bazuar dhe të shqiptojë dënimin më të ulët të paraparë me ligj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shkimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Srpska Lista, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragradi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.*”

Ndërsa nga përgjigja në ankesë, kuptohet se Subjekti Politik Srpska Lista e ka pranuar se nuk kishte leje për vendosje të posteve, cila referohet se aktivistë të rinj dhe pa përvojë të subjektit politik, me dëshirën e tyre për të vendosur sa më shumë materiale zgjedhore, ishin të pakujdeshëm, sepse ky ishte cikli i tyre i parë zgjedhor, dhe se të njëjtit nuk kishin dijeni se vendosja e posterave në hapësira publike ishte vepër e kundërligjshme. Ndërsa pretendimi se i kanë hequr posterat, paneli nuk e mori për bazë nga se subjekti në fjalë nuk ka paraqit prova që do të dëshmonin heqjen e tyre.

Në rastin konkret paneli vlerësoj se Subjekti Politik Srpska Lista për shkak se të njëjtit kanë vendosur postera, në shtyllat elektrike dhe stacionet e autobusëve, dhe se veprimet e tilla paneli i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legiislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik Srpska Lista, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Si rrethanë lehtësuese paneli vlerësoj faktin se Subjekti Politik Srbska Lista e ka pranuar se ka vendos posterat pa leje përkatëse.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nen 118 paragrafi 1 dhe nen 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.358/2025 datë 06.02.2025

Kryesuese i Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.